

VENDIM
Nr.555, datë 16.8.2006

**PËR KTHIMIN E FONDEVE FINANCIARE NGA SUBJEKTET, QË PËRFITOJNË NGA
PËRDORIMI I FONDIT KUNDËRPARTI TË GRANTEVE JAPONEZE, PËR
PROJEKTIN “RRITJA E PODHIMIT, 2KR” DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMET NR.479, DATË 19.7.2001, NR.373, DATË 5.6.2003 DHE NR.114, DATË
25.2.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare” dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vlera e mallrave, pajisjeve, linjave teknologjike të agropërpunimit dhe të serave me ngrohje, që janë financuar dhe vazhdojnë të financohen nga fondi kundërparti, në kuadër të granteve japoneze, sipas vendimeve nr.479, datë 19.7.2001, nr.373, datë 5.6.2003 dhe nr.114, datë 25.2.2005 të Këshillit të Ministrave, të shlyhen si fonde kundërparti nga subjektet përfituese, me vlerën e barazvlefshme, në lekë, të çmimit të blerjes FOB, brenda një afati 7-vjeçar nga çasti i marrjes në dorëzim të mallrave, pajisjeve, linjave dhe serave me ngrohje. Konvertimi në lekë i çmimit të blerjes FOB të bëhet sipas kursit zyrtar të këmbimit të valutës në lekë, në datën e marrjes në dorëzim të mallrave, pajisjeve, linjës ose serës me ngrohje.

Diferencat financiare ndërmjet çmimeve CIF dhe FOB të evidentohen nga projekti “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR” në pakësim të fondeve kundërparti.

2. Njësia e menaxhimit të projektit “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR” të lidhë kontratat me subjektet, të cilat kanë përfituar mallra, pajisje, linja teknologjike dhe sera me ngrohje, për periudhën 2001-2005 e në vazhdim. Kriteret, afatet dhe sanksionet, në bazë të të cilave do të lidhen këto kontrata, të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Financave.

3. Në vendimet nr.479, datë 19.7.2001, nr.373, datë 5.6.2003 dhe nr.114, datë 25.2.2005 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ky ndryshim:

Në pikën 1, të hiqen fjalët “... sipas procedurës së miratuar me vendimin nr.485, datë 21.10.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e shpërndarjes së fondeve të dhëna nga qeveria japoneze, si mbështetje buxhetore për përballimin e gjendjes së krijuar për shkak të krizës në Kosovë”.”.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha